



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN  
UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN  
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

---

Ref. nr.02/1253 Dt. 02/10/2017

---

Në bazë të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ të Masht-it, nr.17/2014 dhe nenit të Udhëzimit Administrativ të Masht-it për kategoritë e studentëve për asistencë si dhe kushtet për fitimin e asistencës, nr.24/2012, si dhe nenit 31 të Ligjit nr. 4/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan shpall

## K O N K U R S

### **Për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan për vitin akademik 2017/2018**

Të drejtë lirimi nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2017/2018 kanë Studentët e Universitetit „Kadri Zeka” (shtetas të Republikës së Kosovës):

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
2. Studentët të cilët janë invalidë dhe veteran të luftës ose janë fëmijë të veteranëve apo invalidëve të luftës ;
3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës;
4. Studentët me aftësi të kufizuara fizike;
5. Dy e më shumë studentë të të njëjtës familje të cilët studiojnë në universitetet publike ( studentit i dytë e lart lirohen nga pagesa).

### **Për t'u liruar nga pagesa studentët paraqesin:**

#### **1. Për kategorinë e studentëve që janë në asistencë sociale ose studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave nevojitet:**

- Vërtetimi nga Qendra për Punës Sociale, me të cilin vërtetohet se familja e studentit është përfituese e ndihmave sociale;
- Vërtetimin nga Enti për punësim me të cilin vërtetohet se asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk janë në marrëdhënie pune si dhe vërtetimin nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa të Kuvendit Komunal me të cilin dëshmohet se asnjëri nga anëtarët e familjes së ngusht nuk ngarkohet me tatim nga të ardhurat katastrale apo se nuk ushtrojnë veprimtari biznesi;
- Vërtetimi nga fakulteti.

## **2. Për studentët të cilët janë invalid dhe veteran të luftës nevojitet:**

- Çertifikata e mjekut specialist dhe
- Vërtetimi nga shoqata e invalidëve dhe veteranëve të luftës;
- Vërtetimi nga fakulteti.

## **3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës;**

- çertifikatën nga zyra e regjistrimit civil të Kuvendit Komunal si dëshmi për humbjen e prindit në luftë;
- Vërtetimin se nuk ushtron veprimtari biznesi pjesa tjetër e familjes dhe
- Certifikatën e lindjes së aplikuesit (studentit/es);
- Vërtetimi nga fakulteti.

## **4. Studentët me nevoja të veçanta:**

- Studentët me nevoja të veçanta për të përfituar asistencë sociale duhet të paraqesin çertifikatën e mjekut specialist me të cilin dëshmohet aftësia e tij e kufizuar fizike;
- Vërtetimi nga fakulteti.

## **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Të gjithë studentët të cilët aplikojnë për asistencë konform kushteve të parapara sipas UA të MASHT-it nr. 24/2012 dokumentet e kërkuar duhet t'i dorëzojnë në njësitë përkatëse akademike nga data **02.10.2017 deri më datë 16.10. 2017.**

Lista e të liruarve nga pagesa do të shpallet në ueb faqen e universitetit [www. uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

